



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 5/1 prot.

Tiranë, më 08.01. 2024

V E N D I M

Nr.2, datë 08.01. 2024

Mbështetur në ligjin nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 273 Regj., datë 26.12.2023, që i përket ankueses znj. Z.L, kundër K.M.C.A.P Tiranë, me pretendimin diskriminimin për shkak të *aftësisë së kufizuar*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të paraqitur në ankesë, ankuesja Z.L, deklaroi se është banuese në lagjen Bregu i Lumit (Treshi), Njësia 11, Laprakë Tiranë. Ajo jeton së bashku me djalin e saj G.L , i cili është diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor.

Znj. L. , shpjegon se, fillimisht djali i saj G.L është diagnostifikuar me çrregullim psikotik dhe kishte halucinacione dhe si pasojë filloi të ishte i dhunshëm. Në vitin 2015 kanë shkuar në Gjermani, ku djali është shtruar në spital me diagnozën skizofreni paranoidiku dhe ka vazhduar të marrë mjekimet sipas përshkrimit të mjekëve. Në vitin 2016, janë kthyer në Shqipëri, ku djali është hospitalizuar në QSUT. Në vitin 2018, djali është shtruar në spital në Zahari, me mjekim të detyrueshëm, për shkak të denoncimit për dhunë të vazhdueshme në familje. Pasi doli nga spitali në vitin 2020, djali ka vazhduar të marrë mjekim ambulator. Ajo shprehet se, djali nuk i merr mjekimet rregullisht dhe nuk e pranon sëmundjen, ka dhunë verbale, fizike, psikologjike dhe është e vështirë të kujdesesh për të. Nuk ka ndërgjegje dhe ka zëra në vesh.

Ankuesja informon se, nga viti 2013 deri me 1 dhjetor 2023 është trajtuar me KEMP. Në nëntor 2023, ajo ka plotësuar dokumentacionin për KEMP dhe kujdestari, pasi djali është i pandërgjegjshëm dhe papërgjegjshëm. Në datën e Komisionit të KEMP-it, djali nuk paraqitet sepse nuk pranon asgjë dhe ajo nuk mund ta marrë me dhunë. Ka tentuar disa herë, por ai nuk shkon për t’u paraqitur para Komisionit. Në rastet e vlerësimeve të mëparshme, znj. L. shprehet se, kanë shkuar në shtëpi për të vlerësuar djalin dhe kështu ai ka vazhduar të trajtohet me KEMP.

Ajo pretendon se tani, anëtarët e Komisionit nuk pranojnë të shkojnë për të bërë vlerësimin e djalit në shtëpi dhe për rrjedhojë djali i saj nuk mund të përfitojë pagesën e aftësisë së kufizuar dhe ankuesja pagesën si kujdestare e djalit

Ankuesja shprehet se ajo është përditë pre e problemeve të tij mendore dhe e ka të pamundur që ta komandojë. Për këtë arsye ajo shprehet se është e padrejtë që të ndodhë ndërprerja e KEMP-it për një person me diagnozë të fortë skizofrenie vetëm se nuk mund të vizitohet në shtëpi. Ajo thekson se është pensioniste me 10.000 lekë pension në muaj, jeton e vetme me një djalë me probleme mendore, pasi bashkëshorti dhe vajza i kanë vdekur, dhe nuk mund të marrë përkrahjen që i takon me ligj.

Në përfundim, ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri rregullimin e situatës duke i mundësuar marrjen e pagesës si kujdestare.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirie dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7/1 i LMD-së¹, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”*.

¹ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b², ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Në datën 03.01.2024 (administruar pranë Komisionerit me Nr.5 prot.) ankuesja ka depozituar një kërkesë me shkrim nëpërmjet të cilës deklaroi: *“Ankesa ime drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u zgjidh. Kërkoj që kjo ankesë të mbyllet”*.

Ankuesja është kontaktuar nëpërmjet telefonit, për të marrë informacion në lidhje me zgjidhjen e ankesës së paraqitur pranë Komisionerit. Ankuesja deklaroi, se, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar kishin kryer vlerësimin e djalit të saj në shtëpi dhe se problematika që ajo kishte paraqitur pranë Komisionerit kishte marrë zgjidhje.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Në nenin 90, *“Përfundimi i procedurës administrative”*, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: *“3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”*. Ndërsa, në nenin 94 *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”*, pikat 1 dhe 3, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: *“1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.3. Në çdo rast, tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës nuk ndikon në vazhdimin e tij, nëse organi publik çmon se vazhdimi i procedurës është në interes publik, me përjashtim të rasteve kur procedura është e tillë që mund të fillojë vetëm me kërkesën e pales.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesja në datën 03.01.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës Nr. 273 regj, datë 26.12.2023, e paraqitur nga ankuesja Z.L , kundër KMCAP Tiranë, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.

² Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”*

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 273, datë 26.12.2023, të paraqitur nga znj. Z.L, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit: Tërheqje nga ankesa